



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:159404

Datë: 31.07.2023

Numri i dokumentit: 04536585

P.nr.13A/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të pandehurit L.G. nga F.K., i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.487/23F të datës 24.07.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 25.07.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Mimoza Shala, të pandehurit L.G. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Bajram Dili, si dhe të dëmtuarës XH.G., me datë 27.07.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.07.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.G., nga i ati S. dhe nëna A. e gjinisë N., i lindur me datë 23.11.1975 në P., me vendbanim në Rrugën “Gj.” Lagja numër .. në F.K., i martuar, me numër personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, me përgatitje shkollore të nivelit fillor, Ashkali, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 23.07.2023 rreth orës 13:45, në shtëpinë e tyre të përbashkët në F.K., saktësisht në lagjen 28, rr. “Gj.”, I pandehuri L.G., me dashje dhe me qëllim të shkaktimit të lëndimeve trupore Brenda marrëdhënies familjare ka përdorë forcën ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij XH.G., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje të atëçastshme mes tij dhe bashkëshortes e cila e akuzon të pandehurin se po e tradhton, në debat e sipër e kishte sulmuar me grushte dhe shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, e kishte kapur për flokë dhe kishte goditur në kokë, nga ku e njëjta ka ikur nga shtëpia tek fqinjët e saj për ta telefonuar policinë, në këtë mënyrë të njëjtës i shkakton lëndime të lehta trupore sipas akt ekspertizës mjeko- ligjore, të cilat si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme në shëndet.

- *Me këtë, ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurin e **gjykon** me:

DËNIM ME BURGIM

- I. Në kohëzgjatje prej **shtatë (7) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- II. Në bazë të nenit 79 të KPRK-së të akuzuarit L.G., koha e kaluar në paraburgim nga data 25.07.2023 e tutje do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.
- III. E dëmtuara XH.G., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.
- IV. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- V. Të pandehurit me Aktvendim të veçantë i është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë së bashku me kërkesë për caktimin e paraburgimit P.II.nr.487/23F e datës 24.07.2023, ndaj të pandehurit L.G. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjyqtarja ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 25.07.2023, në ora 09:00, ku ka dëgjuar palët lidhur me propozimin për caktimin e masës së paraburgimit ku të pranishëm ishin Prokurori i Shtetit Mimoza Shala, i pandehuri L.G. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Bajram Dili dhe e dëmtuara XH.G..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë

ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara Raporti fillestar i incidentit: deklaratat e të dëmtuarës/dëshmitares XH.G., akt ekspertiza mjeko ligjore nr.ef.pr.117 e datës 24.07.2023 e hartuar nga Dr. N.U. ekspert mjeko ligjor, deklaratat e të pandehurit L.G., si dhe provat dhe foto dokumentacioni tjetër që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të pandehurit L.G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprime të tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i pandehuri edhe më parë kishte ushtruar dhunë fizike dhe psikike ndaj të dëmtuarës - viktimës së njëjtë për çka disa herë ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për llojin e njëjtit të veprës penale, është konstatuar nga provat e lëndës se prezenca e dhunës së ushtruar ndaj të dëmtuarës me rastin e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri ishte e lartë e cila dhunë fizike e psikike ishte vërtetuar nga Akt-ekspertiza mjekësore prezantuar si provë në këtë Gjykatë, faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare duke pasqyruar këtu faktin se i pandehuri me viktimën janë në marrëdhënie bashkëshortore dhe dhuna e ushtruar ka ndodhur në ambientin familjarë me çka i pandehuri me veprimet e tij ka ven mbarë familjen nën presion të madh psikik dhe shqetësim emocional me theks të veçantë fëmijët e tyre të mitur, e po ashtu si rrethanë rënduese ishte edhe shkalla e dashjes me rastin e kryerjes së veprës penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 42 të KPRK-së të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikojë edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109 gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shume prej 20 euro, si dhe paushallin gjyqësor

në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Me Aktvendim të veçantë të pandehurit Gjykata i ka vazhduar paraburgimin deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi ne kontest civil për realizimin e kërkesës se saj pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.13A/2023 më datë 31.07.2023**

Gjyqtarja Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.